



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 443/ 2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me seli në Malishevë dhe Iniciativës Qytetare, paraqitur për shkak të sulmit fizik në komunën e Malishevës gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me seli në Malishevë dhe Iniciativës Qytetare për Malishevë (IQM): Anr.443/2013, dhe Anr.529/2013,

**Arsyetim**

PZAP, më datë 03.11.2013, dhe me datën 04.11.2013 ka pranuar ankesat: Anr.443/2013, Anr.529/2013, , nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me seli në Malishevë, dhe nga Iniciativa Qytetare e Malishevës (IQM) me të cilat pretendohet se gjatë ditës së votimit ka ndodhur sulmi fizik ndaj anëtarëve të saj.

- Në ankesën Anr. 443/2013 të PDK-së pretendohet se në vendvotimin në Senik të Malishevës se me datën 03.11.2013 rreth orës 10:300 militanti i IQM-së Musli Zulfaj ka sulmuar fizikisht aktivistin e PDK-së Blerim Zulfaj. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 34 të LZP-së
- Në ankesën Anr.529/2013, të IQM-së pretendohet se Blerim Zulfaj njeri i afërt me PDK-në ka tentuar për ti shantazhuar dhe kërcënuar qytetarët të cilët shkonin për të votuar lirshëm dhe i ka ofruar shpërblime financiare. Me të dëgjuar për këtë se i lartpërmenduri ka ofruar shpërblime financiare ka reaguar verbalisht Musli Zulfaj ndërsa ndaj tij ka reaguar Blerim Zulfaj duke e ofenduar ku edhe ka ardhur deri te konflikti verbal e jo fizik ashtu siç thuhet. Me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon që të merren masat e parapara për ndëshkimin e subjektit politik PDK.

Lidhur me këtë PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës për rastin në fjalë dhe kërkoi që ta informoj PZAP-in.

Në raportin e Policisë të datës 04.11.2013 me nr të rastit 2013 GE 719 theksohet se me datën 03.11.2013 rreth orës 09:30 në fshatin Senik të Malishevës konkretisht para oborrit të shkollës Gjergj Fishta dy persona të dyshuar Musli Zulfaj dhe Blerim Zulfaj fillimisht kanë bërë kërcënime ndaj njëri tjetrit përmes telefonit e më vonë ka rezultuar edhe me dhunë fizike. Sipas raportit të policisë me këtë rast ka intervenuar policia e Kosovës duke i sjellë në stacionin policor në Malishevë ku është hapur rasti dhe ekipi i hetuesve rajonal nën udhëheqjen e prokurorit të shtetit është marrë me rastin dhe pas intervistimit të dyshuarve me vendim të prokurorit të dyshuarit janë ndaluar në ndalim policorë për 48 orë dhe se ndaj tyre është parashtruar kallëzim penal.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

#### **Ankesat janë të pabazuara.**

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund të rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet ankimore se të dëmtuari janë anëtarë apo simpatizantë të subjekteve të lartpërmendura PDK dhe IQM, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë me nr 2013 GE 719 të datës 03.11.2013, në të cilën për asnjë moment nuk kanë arritur që të vërtetojnë se personat e lartpërmendur i përkasin subjekteve politike të lartcekura, ndërsa rreth shkaktimit të lëndimit trupor, për këtë çështje është hapur procedurë pranë prokurorisë kompetente dhe çështja është në procedure të rregullt gjyqësore, prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 443/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.